



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 82

Tiranë – E mërkurë, 18 maj 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 9568, datë 4.5.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4555
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 11.5.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 4555
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 11.5.2016	Për përcaktimin e masës dhe të kriterëve të kompensimit të dëmit të shkaktuar ndaj pronës së punonjësit të Policisë Ushtarake gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj..... 4555
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 351, datë 11.5.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 43, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve”..... 4556
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 11.5.2016	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ)..... 4557
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 11.5.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 83, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”..... 4559
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 11.5.2016	Për miratimin e licencës së koncesionit për rafineri shoqërisë aksionare “AM-OIL”..... 4559
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 356, datë 11.5.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 1086, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e task-forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, të ndryshuar..... 4561
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 358, datë 11.5.2016	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Olesia Bregu..... 4561

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 11.5.2016	Për miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e fondit për shërbimin universal postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit, në rastin e bashkëfinancimit nga ofruesit e shërbimit universal postar.....	4562
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 12, datë 13.5.2016	Për përcaktimin e procedurave të hapjes dhe mbylljes së adresave sekondare të basteve sportive.....	4564
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 1628/6, datë 11.5.2016	Për shpronësim për shkak të ndërtimit të varrezave publike “Burdullias”, në Bashkinë e Beratit.....	4564
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Rural nr. 2604, datë 11.5.2016	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rishikim i projektit të zbatimit të fazës së parë të vijës bregdetare të qytetit të Vlorës”.....	4565
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Lodovik Gruda.....	4565

**DEKRET**

Nr. 9568, datë 4.5.2016

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Sedat Erol Şimşek
2. Emre Naci Sertel
3. Violetta Valerij Lekaj (Volkova)
4. Mehmet Durmuş Ali Gül
5. Ayşe Ali Gül (Gürbüz)
6. Ismail Erdem Mehmet Gül
7. Ahmet Mehmet Yıldizoğlu
8. Hüseyin Raşit Kaya
9. Georgios Charalambos Blekas
10. Shpresa Ejup Latifaj (Krasniqi)
11. Muammer Şaban Efiloğlu
12. Njomza Haki Ulaj (Berisha)
13. Ömer Sabri Kosovali
14. Fausto Rino Carlo Sbolli
15. Giuseppe Rino Carlo Sbolli
16. Salih Mustafa Beşen
17. Hatice Mehmet Gök (Saribaş)
18. Asije Rahman Rahmani
19. Shaban Daut Haxhoviti
20. Giulio Francesco Valente
21. Annina Giuseppe Iellimo
22. Dilaver Muzaffer Baydi
23. Yüksel Osman Atasoy (Açikgöz)
24. Hamdy Abdelsayed Abouhassan
25. Ismail Satilmiş Kirci
26. Hakan Mehmet Şükrü Kaçar
27. Dilara Hakan Kaçar
28. Domingen Mark Bibaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM

Nr. 349, datë 11.5.2016

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN,
QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË
HUAJVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në aneksin nr. 3, “Lista e shteteve, shtetasit e të cilave hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 513, datë. 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen:

“Arabia Saudite, Katari, Omani, Rusia, Gjeorgjia, Bjellorusia, me dokumentin pasaportë, për periudhën 15 maj – 1 nëntor 2016.”

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 350, datë 11.5.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DHE TË
KRITEREVE TË KOMPENSIMIT TË
DËMIT TË SHKAKTUAR NDAJ PRONËS
SË PUNONJËSIT TË POLICISË
USHTARAKE GJATË KRYERJES SË
DETYRËS OSE PËR SHKAK TË SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr. 13/2015, “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake, për dëmin e shkaktuar ndaj pronës së tij gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, përfiton kompensim në lekë, në masën 100 për qind të vlerës së pronës së dëmtuar.

2. Kriteret për përfitimin e kompensimit janë si më poshtë vijon:

a) Të jetë shkaktuar dëm ndaj pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme të punonjësit të Policisë Ushtarake;

b) Dëmi të jetë shkaktuar gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj;

c) Pasuria, ndaj së cilës është shkaktuar dëmi, të jetë në pronësi ose bashkëpronësi të punonjësit të Policisë Ushtarake;

ç) Punonjësi të mos ketë përfituar dëmshpërblim për dëmin nga shoqëri sigurimi;

d) Kur vërtetohet se shkaktuesi i dëmit është dënuar në mungesë ose është shpallur i pamundur për të shlyer detyrimin civil, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

3. Ministri i Mbrojtjes, për raste të dëmtimit të pronës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, ngre një komision për vlerësimin e dëmit. Urdhri për ngritjen e komisionit i komunikohet menjëherë, në rrugë zyrtare, punonjësit të Policisë Ushtarake, prona e të cilit është dëmtuar.

4. Komisioni për vlerësimin e dëmit përbëhet nga 5 anëtarë, drejtohet nga zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe ka në përbërje, të paktën, një përfaqësues nga Policia Ushtarake.

5. Vendimi i komisionit të vlerësimit të dëmit bazohet në dokumentacionin që paraqitet nga vetë kërkuesi, si më poshtë vijon:

a) Vendimin e gjykatës ose të prokurorisë, në të cilën është përcaktuar shkaku dhe vlera e dëmit në pasurinë e paluajtshme ose të luajtshme;

b) Vërtetimin e pronësisë, që punonjësi i Policisë Ushtarake është pronar ose bashkëpronar i pasurisë së paluajtshme ose të luajtshme të dëmtuar;

c) Vërtetimin nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, që punonjësi nuk ka përfituar dëmshpërblim për dëmin nga shoqëri sigurimi.

6. Komisioni për vlerësimin e dëmit dhe hartimin e dokumentacionit merr vendim brenda 15 ditëve nga momenti i paraqitjes së dokumen-

tacionit nga punonjësi i Policisë Ushtarake.

7. Ministri i Mbrojtjes nxjerr urdhrin e dëmshpërblimit brenda 30 ditëve nga momenti i paraqitjes së vendimit të komisionit.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Vendimi nr. 163, datë 18.3.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe masën e kompensimit të dëmeve shkaktuar pronës së punonjësve të Policisë Ushtarake gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj”, shfuqizohet.

10. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 351, datë 11.5.2016

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 43, DATË 16.1.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE
STATUSIN E AUTORITETIT TË
KONTROLLIT SHTETËTOR TË
EKSPORTEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9 e 14, të ligjit nr. 9707, datë 5.4.2007, “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe teknologjive, me përdorim të dyfishtë”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 43, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 2.6 të kreut III, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:



“Certifikata e regjistrimit për personat juridikë/ fizikë, privatë apo publikë lëshohet nga AKSHE-ja, me një afat jo më të gjatë se 3 vjet. Procedurat për rinovim janë të njëjta me procedurën e aplikimit.”

2. Pas pikës 2.7 të kreut III, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“AKSHE-ja ushtron veprimtaritë e kontrollit në të gjitha fazat e procesit, nëpërmjet specialistëve të punësuar pranë AKSHE-së ose nëpërmjet ekspertëve të jashtëm, në rastet kur nevojitet ekspertizë teknike për klasifikimin e mallrave ushtarake apo mallrave me përdorim të dyfishtë. Shpenzimet që mund të nevojiten për një ekspertizë teknike të specializuar në laboratorë, institute kërkimi ose institucione të tjera të specializuara, për klasifikimin e mallrave ushtarake apo mallrave me përdorim të dyfishtë, mbulohen nga subjekti privat apo publik i interesuar për klasifikimin e këtyre mallrave.”

3. Pika 3 e kreut IV, shfuqizohet.

4. Në pikën 4 të kreut IV, fjalët “... dhe nënkryetarit ...”, shfuqizohen.

5. Pika 5 e kreut IV, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Marrëdhëniet juridike të punës së nëpunësve të AKSHE-së mbështeten në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.”

II. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 3, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndarja me numër rendor 29 shfuqizohet.

III. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 352, datë 11.5.2016

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT INFORMATIK FINANCIAR TË QEVERISË (SIFQ)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të thesarit, të quajtur Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ).

2. SIFQ-ja përmban:

a) të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit të njësisve të qeverisjes së përgjithshme;

b) të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare të qeverisë, në përputhje me bazën ligjore për financat publike;

c) të dhëna referenciale për ndërveprimin dhe baza të dhënash të tjera;

ç) informacione të tjera plotësuese, për procese të punës së financave të shtetit;

d) të dhëna për raporte financiare dhe statistika.

3. Përbërësit e arkitekturës *software* dhe *hardware* të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e gjeneruara nga SIFQ-ja dhe që kanë të bëjnë me kodifikimin e klasifikimit buxhetor e kontabël, të cilat janë:

- i) Kodet e institucioneve;
- ii) Kodet e ministrive të linjës;
- iii) Kodi i kapitullit (burimi i financimit);
- iv) Kodi i programit;
- v) Kodet e llogarive ekonomike;
- vi) Kodet e entiteteve qeverisëse;
- vii) Kodet e nënllogarive;
- viii) Kodet e degëve të thesarit;
- ix) Kodi i projektit.



b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat referenciale:

i) të bankave të nivelit të dytë, si IBAN-i, numri i llogarisë bankare, adresa e bankës;

ii) të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si NIPT-i i subjektit/institucionit.

5. Subjektet përgjegjëse të SIFQ-së, janë, si më poshtë vijon:

a) Institucioni administrues i SIFQ-së është Ministria e Financave;

b) Institucionet, palë të interesuara, janë: Ministria e Financave, degët e thesarit, institucionet që operojnë me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, PIU-projektet me financim të huaj, bankat e nivelit të dytë dhe universitetet publike që kanë akses me ndërfaqe me SIFQ-në.

6. Dhënës të informacionit janë:

a) degët e thesarit;

b) Ministria e Financave;

c) institucionet që operojnë me akses të drejtpërdrejtë në SIFQ;

ç) Banka e Shqipërisë;

d) bankat e nivelit të dytë;

dh) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

e) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

ë) Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

f) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Sigurimit Shëndetësor;

g) projektet me financim të huaj.

7. Subjekte të interesuara, janë:

a) Ministria e Financave;

b) degët e thesarit;

c) institucionet që kanë akses të drejtpërdrejtë në SIFQ;

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

d) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

dh) Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

e) Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Sigurimit Shëndetësor;

ë) projektet me financim të huaj;

f) Banka e Shqipërisë;

g) universitetet publike, që kanë akses në ndërfaqen me SIFQ-në;

gj) bankat e nivelit të dytë;

h) çdo subjekt tjetër, i përcaktuar shprehimisht me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të SIFQ-së është, si më poshtë vijon:

a) Administratorët e SIFQ-së kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave në SIFQ, në lidhje me menaxhimin e përdoruesve, klasifikimin buxhetor e kontabël dhe subjekteve të regjistruara;

b) Degët e thesarit kanë të drejtë leximi, shkrimi/modifikimi ose anulimi vetëm për transaksionet që regjistrojnë në SIFQ, dhe të drejtë leximi/monitorimi të balancave buxhetore/kontabile të institucioneve të varësisë;

c) Ministrinë e linjës kanë të drejtë leximi, shkrimi/modifikimi ose anulimi vetëm për transaksionet që regjistrojnë në SIFQ;

ç) Banka e Shqipërisë ka të drejtë leximi, për pagesat që regjistrohen në SIFQ dhe shkrimi, për konfirmimin e shlyerjes së pagesave, nëpërmjet dërgimit të skedarëve të konfirmimit, të cilët importohen në SIFQ;

d) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka të drejtë leximi për pagesat në favor të DPT-së, që regjistrohen në SIFQ dhe të drejta shkrimi për konfirmimin e shlyerjes së pagesave, nëpërmjet dërgimit të skedarëve të konfirmimit, të cilët importohen në SIFQ dhe kontabilizimit të të ardhurave tatimore;

dh) Bankat e nivelit të dytë kanë të drejtë shkrimi për rakordimin e pagesave që regjistrohen në SIFQ dhe shlyhen nga bankat, nëpërmjet dërgimit të skedarëve të konfirmimit, të cilët importohen në SIFQ;

e) Universitetet publike kanë të drejtë leximi për transaksionet e pagesave që regjistrohen në SIFQ në favor të tyre, nëpërmjet aksesimit të raporteve të të ardhurave;

ë) ISSH-ja dhe FSDKSH-ja kanë të drejtë leximi dhe shkrimi/modifikimi të balancave kontabile të institucioneve të tyre respektive;

f) Ministria e Financave ka të drejta administrative mbi SIFQ-në, në rolet:

i) Administrator;

ii) Raportues;

iii) Auditues;

iv) Zhvillues.



9. Baza e të dhënave e SIFQ-së ndërvepron me baza të tjera të dhënash: me sistemin e tatimeve, me Bankën e Shqipërisë, me bankat e nivelit të dytë dhe me universitetet.

10. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 353, datë 11.5.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 83, DATË 3.2.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË KRIJIMIT TË NJËSIVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 26, të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 4 e vendimit nr. 83, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Njësitë publike që krijojnë njësinë e auditimit të brendshëm, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nuk programojnë të kryejnë shërbimin e auditimit të brendshëm për njësitë e varësisë, të cilat kanë në strukturën e tyre organizative njësi të auditimit të brendshëm. Ky shërbim në njësitë e varësisë mund të kryhet në raste të veçanta me urdhër të titullarit të njësisë publike të organit epror.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 355, datë 11.5.2016

PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË KONCESIONIT PËR RAFINERI SHOQËRISË AKSIONARE “AM-OIL”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 19, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e licencës së koncesionit për rafineri shoqërisë aksionare “AM-OIL”, me NIPT K94210401A dhe seli në ish-Uzinën e Plastmasit, Lushnjë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LICENCË KONCESIONI PËR RAFINERI
Nr. _____, datë _____.____.2016

Në mbështetje të nenit 18, pika 2, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 19, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”, shoqëria aksionare “AM-OIL” është pajisur me miratim paraprak nr. 2034/3, datë 8.10.2015, nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.



I jepet shoqërisë aksionare “AM-OIL”, me seli në ish-Uzina e Plasmasit, Lushnjë, licenca e koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto dhe për prodhimin e nënprodukteve të saj.

a) Emri dhe selia e personit juridik:

Shoqëria aksionare “AM-OIL” me seli në ish-Uzina e Plasmasit, Lushnjë. Regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, datë 10.6.2009, me NUIS: K94210401A.

b) Koordinatat dhe vendndodhja e rafinerisë:

Nr.	Koordinatat gjeodezike	
	Lindje	Veri
1	4391289.392	4533429.828
2	4391328.887	4533407.273
3	4391329.828	4533408.919
4	4391346.062	4533399.599
5	4391345.098	4533397.678
6	4391370.417	4533383.040
7	4391469.304	4533424.754
8	4391467.016	4533429.187
9	4391470.270	4533430.951
10	4391453.882	4533465.384
11	4391448.397	4533479.088
12	4391434.530	4533529.501
13	4391417.605	4533541.670
14	4391409.592	4533575.525
15	4391398.875	4533580.070
16	4391386.824	4533559.369
17	4391397.522	4533553.200
18	4391393.658	4533546.430
19	4391388.860	4533549.176
20	4391377.184	4533528.807
21	4391356.848	4533539.639
22	4391300.439	4533443.248
23	4391297.084	4533444.968

c) Numri dhe data e vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit për miratimin e lejes së ndërtimit/zhvillimit:

- “Leje ndërtimi” me vendim nr. 30, datë 1.4.2011 objekti: “Ndryshim destinacioni nga repart mallrash në fabrikë riciklimi vajrash”, nga Bashkia Lushnjë; dhe

- “Leje ndërtimi” me vendim nr. 20, datë 20.10.2015 objekti: “Shtesë linje (në fabrikën e riciklimit të vajrave), për rafinimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” nga Bashkia Lushnjë.

ç) Lloji i licencës së tregtimit dhe afati i saj, nëse personi juridik është pajisur me këtë licencë;

Licencë tregtimi me shumicë LN-6222-03-2013, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të benzinës kat. II/A; gazoil kategoria III/A, solar kat: IV/B; bitum kat. V/A; naftë bruto kat. 0/A.

Afati i vlefshmërisë së kësaj licence është pa afat.

d) Afati i vlefshmërisë së licencës së koncesionit, 30 vjet me të drejtë përsëritjeje pas miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave.

E drejta për rinovimin e kësaj licence bëhet sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në kreun V, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 14.1.2015, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”.

dh) Afati i përfundimit të ndërtimit të rafinerisë, afati i vënies në përdorim, si dhe rastet kur do të lejohet shtyrja e afatit të ndërtimit apo vënies në përdorim.

Objekti ka qenë i ndërtuar dhe ka filluar punë si impiant për përpunimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, duke përfshirë edhe riciklim vajrash, në vitin 2013.

e) E drejta e organeve dhe institucioneve shtetërore, të ngarkuara me ligj, për kontrollin e zbatimit të projektit sipas kushteve dhe afatit të përcaktuar në projekt;

Nuk aplikohet pasi rafineria është e ndërtuar.

ë) Këshilli i Ministrave ka të drejtë revokimin e kësaj licence kur nga kontrollet e ushtruara nga organet dhe institucionet shtetërore, të ngarkuara me ligj, konstatohet dështimi i përmbushjes së kërkesave të Licencës së Koncesionit për Rafineri, në zbatimin e parametrave teknikë, në afatin e realizimit të projektit dhe të normave mjedisore, në përputhje me pikën 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 19, datë 14.1.2015, “Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj”;

f) Kapaciteti dhe kategoria e produkteve që do të prodhohë rafineria.

Kapaciteti i përpunimit të naftës bruto është 500 tonë/24 orë.

Produktet që do të prodhohë rafineria janë të përshkruara në kartën teknologjike të lëshuar nga ISHTI-ja, bashkëlidhur licencës, e cila është pjesë e integruar e saj.



g) Shoqëria aksionare “AM-OIL”, pas miratimit të kësaj licence koncesioni duhet të paguajë detyrimet financiare si më poshtë:

i) Bonusin e nënshkrimit të licencës në vlerën 1 001 000 (një milion e një mijë) lekë;

ii) Bonusin vjetor të trajnimit në vlerën 2 000 (dy mijë) USD;

iii) Tarifa e licencimit në vlerën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë.

gj) Shoqëria aksionare “AM-OIL” pas miratimit të kësaj licence koncesioni, në zbatim të kërkesave të nenit 9, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, ka detyrim mbajtjen e rezervës së sigurisë, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara këtu.

h) Shoqëria aksionare “AM-OIL” pas miratimit të kësaj licence koncesioni duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet, informacionet dhe të dhënat përkatëse, brenda afateve, në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

i) Shoqëria aksionare “AM-OIL” në rastin e ndryshimeve në skemën dhe kartën teknologjike të funksionimit të rafinerisë, si dhe për markën e cilësinë e nënprodukteve të naftës të prodhuara nga rafineria, duhet të zbatojë përcaktimet e nenit 12, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

Kjo licencë koncesioni për rafineri, do të udhëhiqet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim, pretendim ose ndryshim opinioni, që lind nga/ose në lidhje me këtë licencë koncesioni, do bëhet nga Gjykata e Tiranës.

MINISTRI I ENERJISË HE INDUSTRIE
Damian Gjikhuri

VENDIM

Nr. 356, datë 11.5.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1086, DATË 14.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË ARKËTIMEVE DHE ULJEN E NIVELIT TË HUMBJEVE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES SË ENERJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 6, të vendimit nr. 1086, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... deri më 30 qershor 2016...”, zëvendësohen me “... deri më 30 qershor 2017...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 358, datë 11.5.2016

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË FËMIJËS OLESIA BREGU

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të fëmijës Olesia Bregu, në masën 4 000 000 (katër milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM**

Nr. 360, datë 11.5.2016

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E
FONDIT PËR SHËRBIMIN UNIVERSAL
POSTAR DHE MËNYRAT E
PËRCAKTIMIT TË KONTRIBUTIT, NË
RASTIN E BASHKËFINANCIMIT NGA
OFRUESIT E SHËRBIMIT UNIVERSAL
POSTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e fondit për shërbimin universal postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit, në rastin e bashkëfinancimit nga ofruesit e shërbimit universal postar, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

SHTOJCË

**RREGULLA PËR KRIJIMIN DHE
ADMINISTRIMIN E FONDIT PËR
SHËRBIMIN UNIVERSAL POSTAR DHE
MËNYRAT E PËRCAKTIMIT TË
KONTRIBUTIT, NË RASTIN E
BASHKËFINANCIMIT NGA OFRUESIT E
SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR**

Neni 1**Objekti**

Ky dokument ka si objekt përcaktimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e fondit të shërbimit universal postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit, në rastin e bashkëfinancimit nga ofruesit e shërbimit universal postar.

Neni 2**Parime të përgjithshme**

1. Shërbimi universal postar është shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik për publikun.

2. Kompensimi për koston neto të shërbimit universal postar bazohet në parimet e objektivitetit, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.

3. Kompensimi për koston neto të shërbimit universal postar nuk duhet të krijojë deformime të konkurrencës në treg.

Neni 3**Termet e përdorur**

Termet e përdorur në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me ato të dhëna nga ligji “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligji “Për ndihmën shtetërore”.

Neni 4**Përcaktimi i koston neto**

Kostot neto për ofrimin e shërbimit universal postar llogariten si diferencë ndërmjet koston neto për sigurimin e këtij shërbimi dhe kostove që ofruesi i shërbimit universal postar do të kishte pasur nëse nuk do të ishte ofrues i shërbimit universal postar, bazuar në rregullat e përcaktuara dhe të miratuara nga AKEP-i, në zbatim të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 5**Kompensimi i shërbimit universal postar**

E drejta e kompensimit për koston neto të ofruesit të shërbimit universal postar lind atëherë kur AKEP-i, pas verifikimit të kryer sipas ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se ofrimi i shërbimit universal postar shkakton koston neto shtesë, që përbën një ngarkesë të padrejtë financiare për ofruesin e shërbimit universal postar.

Neni 6**Mënyrat e kompensimit**

Mënyrat e kompensimit për koston neto të shërbimit universal postar janë:

a) kompensimi me fonde publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore;

b) krijimi i fondit të kompensimit me bashkëfinancim të ofruesve të shërbimit postar dhe administrimi i fondit nga AKEP-i;



c) Kombinimi i shkronjave “a” dhe “b” të këtij neni, në rastet kur aplikimi vetëm i një mekanizmi nuk është i mjaftueshëm për mbulimin e kostove neto të shërbimit universal.

Neni 7

Kompensimi me fonde publike

1. AKEP-i, në përfundim të analizës, i përcjell ministrit përgjegjës për shërbimet postare raportin e vlerësimit për koston neto të shërbimit universal postar për vijimin e procedurës me Komisionin e Ndhmës Shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën shtetërore.

2. Ministri i propozon Komisionit të Ndhmës Shtetërore mbulimin e koston neto të shërbimit universal postar në një nga format/mënyrat e përcaktuara në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

3. Zbatimi i kompensimit me ndihmë shtetërore për ofrimin e shërbimit universal postar do të kryhet vetëm pas miratimit nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore.

4. Me marrjen e vendimit të Komisionit të Ndhmës Shtetërore, ministri i përcjell AKEP-it vendimin dhe i kërkon, sipas rastit, krijimin e fondit të kompensimit me bashkëfinancim.

Neni 8

Kompensimi me bashkëfinancim

1. Në rastin e aplikimit të bashkëfinancimit të kostove neto të shërbimit universal nga ofruesit e shërbimit postar, AKEP-i krijon fondin e kompensimit nga të ardhurat e operatorëve postarë, duke hapur një llogari të veçantë bankare dhe duke mbajtur një regjistër të veçantë kontabël.

2. AKEP-i krijon fondin e kompensimit me bashkëfinancim, nëse kjo është e nevojshme, pas vendimit të Komisionit të Ndhmës Shtetërore, sipas përcaktimeve të pikës 7, të nenit 16, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

3. Fondi i kompensimit krijohet nga kontributet e ofruesve të shërbimit postar, bazuar në ndarjen e llogarive, për të evidentuar të ardhurat që vijnë nga shërbimet postare si zë më vete dhe të ndara nga të ardhurat që vijnë nga aktivitete të tjera të biznesit.

4. Kontributi i secilit prej ofruesve të shërbimit universal postar duhet të jetë në proporcion me të ardhurat e përfituara nga ofrimi i shërbimit universal postar dhe nga ofrimi i shërbimeve të

tjera alternative. Kontributi i një ofruesi të shërbimit postar përcaktohet me vendim të AKEP-it.

5. Kontributi për fondin e shërbimit universal nga çdo ofrues duhet të jetë deri në 1% e të shumë së të ardhurave vjetore të ofruesit të shërbimit postar.

6. Nëse kontributi i një ofruesi të shërbimit universal postar në fondin e kompensimit është më i vogël se kompensimi i llogaritur për ofrimin e shërbimit universal postar, atëherë ky ofrues i shërbimit universal postar nuk do të kontribuojë në fondin e kompensimit.

7. AKEP-i llogarit shumën e kontributit të secilit ofrues të shërbimeve postare në fondin e kompensimit me bashkëfinancim, mbi bazën e koston neto dhe të parimit të proporcionalitetit, bazuar në të ardhurat dhe pjesët përkatëse të tregut të ofruesve të shërbimit universal postar.

Neni 9

Administrimi i fondit të krijuar me bashkëfinancim

1. Fondi i kompensimit të krijuar me bashkëfinancim të ofruesve të shërbimit universal postar administrohet nga AKEP-i. Ky fond nuk mund të përdoret për qëllime të tjera dhe, nëse nuk shpenzohet, akumulohet dhe mbartet në vitin pasardhës.

2. Shuma për kompensimin e shërbimit universal postar auditohet në bazë vjetore nga një grup ekspertësh kontabël të autorizuar nga AKEP-i.

Neni 10

Kompensimi i koston neto në mënyrë të kombinuar

1. Kur detyrimi për shërbimin universal postar kërkon zgjerim të infrastrukturës së pikave të aksesit të rrjetit postar, për kompensimin e koston neto të shërbimit universal postar mund të aplikohet mekanizmi i kombinuar, sipas shkronjës “c”, të nenit 6, të këtij dokumenti.

2. Mbulimi i koston neto me ndihmë shtetërore, në këtë rast, do të bëhet në nivelin e lejuar në legjislacionin për ndihmën shtetërore, të ndryshuar. Pjesa tjetër e kostove për pëmbushjen e detyrimit të shërbimit universal do të mbulohet me bashkëfinancim të ofruesve të shërbimit postar.

3. Në rastin e detyrimeve të shërbimit universal, që lidhen me zgjerimin e infrastrukturës së pikave



të aksesit në rrjetin postar, AKEP-i mund të përcaktojë detyrimin për financim të shërbimit universal edhe ndaj ofruesit të shërbimit postar, sipas nenit 20, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

UDHËZIM

Nr. 12, datë 13.5.2016

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË HAPJES DHE TË MBYLLJES SË ADRESAVE SEKONDARE TË BASTEVE SPORTIVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 4, të nenit 18, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Shoqëritë e lojërave të fatit të licencuara në kategorinë e basteve sportive, për hapjen e adresave sekondare të ushtrimit të aktivitetit duhet të paraqesin në Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF) dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesë për hapjen e pikave dhe adresën e saktë të saj;

b) Kopje të letërnjoftimit dhe kontratës së punës për punonjësin, i cili do të jetë i punësuar në këtë pikë;

c) Miratimin paraprak të marrë në AMLF nga pronari i ambientit në të cilin do të ushtrohet aktiviteti i lojërave të fatit, sipas përcaktimeve të nenit 3, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”;

ç) Kopje e njësuar me origjinalin e kontratës së qirasë/huapërdorjes, hartuar e nënshkruar përpara noterit, bashkëlidhur certifikata /vërtetimi i pronësisë apo dokument tjetër që provon të drejtën e qiradhënesit/huadhënesit për të poseduar dhe gëzuar ligjrisht ambientin e dhënë me qira apo në huapërdorje;

d) Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore.

Për punonjësin, i cili do të jetë i punësuar në këtë pikë shoqëria duhet të zotërojë në dosjen e personelit, në selinë e shoqërisë, dokumentacionin e poshtëshënuar:

b.1 kopje e letërnjoftimit;

b.2 vërtetim i gjendjes gjyqësore;

b.3 dëshmi kualifikimi;

b.4 kontratë pune.

2. Shoqëritë e lojërave të fatit të licencuara në kategorinë e basteve sportive për mbylljen e adresave sekondare duhet të paraqesin në AMLF dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Njoftimin për mbylljen e sallës.

b) Dokument që vërteton zgjidhjen e kontratës për ambientet e marra me qira.

3. Shoqëritë e lojërave të fatit nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë në një pikë të caktuar pa marrë miratimin me shkrim nga AMLF-ja për hapjen e pikës sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

4. Në udhëzimin nr. 5, datë 19.1.2009, “Për procedurat e hapjes dhe të mbylljes së sallave të lojërave basteve sportive, kazinove elektronike, bingove tradicionale” shfuqizohen vetëm dispozitat që normojnë bastet sportive.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Arben Ahmetaj

KËRKESË

Nr. 1628/6, datë 11.5.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme, shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkues është Bashkia e Beratit. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, për shkak të ndërtimit të varrezave publike “Burdullias”, në Bashkinë e Beratit është 11 419 590 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatës në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTRI I PUNËVE
TË BRENDSHME
Elona Gjebrea



LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË SHPRONËSIMIT, QË DO TË PËRDORET PËR “ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE “BURDULLIAS””, NË BASHKINË E BERATIT

Nr.	Emri Mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja m ² truall	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit të pronësisë
1	Feride Bego Myrifete Peshtani	4/157	8501	2730	4183	11 419 590	Konfirmim nga ZVRPP-ja me shkresën nr. 3209/1 prot., datë 19.8.2015
						11 419 590	

KËRKESË

Nr. 2604, datë 11.5.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rishikim i projektit të zbatimit të fazës së parë të vijës bregdetare të qytetit të Vlorës”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së

masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 79, 245,263 (shtatëdhjetë e nëntë milionë e dyqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I ZHVILLIMIT
URBAN
Gjon Radovani

LISTA E PASURIVE TË LUAJTSHME QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT “RISHIKIMI I PROJEKTTIT TË FAZËS SË PARË TË VIJËS BREGDETARE TË QYTËTIT TË VLORËS” (SIPAS VLERAVE PARAPRAKE TË BASHKISË VLORË)

Truall sipas VKM-së nr. 89/2016=10903 lekë/m², sipas gjurmës së projektit, miratuar me vendimin nr. 1, datë 25.4.2016. Kostoja e ndërtimit sipas udhëzimit nr. 4, datë 30.9.2015 të EKB-së.

Nr	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Sipërfaqja truallit	Sipërfaqja ndërtimi	Çmimi i truallit, leke	Çmimi i ndërtimit, leke	Vlera e truallit, leke	Vlera e ndërtimit, leke	Vlera truall dhe ndërtësë	Konfirmimi i ZVRPP-Vlore
1	8602	36/122/2	Lumturi dhe Vladimir Varfi	250.00		10,903.00		2,725,750.00	0.00	2,725,750.00	Konfirmuar nga ZVRPP- Vlore.
2	8602	36/123/ND	Lumturi dhe Vladimir Varfi		311.00		45,522.00	0.00	14,157,342.00	14,157,342.00	Konfirmuar nga ZVRPP- Vlore.Urdher kufizimi.
3	8602	36/125	Turi Aligjoni, Flavia Aligjoni	299.92	330.00	10,903.00	45,522.00	3,270,027.76	15,022,260.00	18,292,287.76	Konfirmuar nga ZVRPP- Vlore. Objekti është ndertese dy kate. Inskriptohet ne favor te B.K.T.-se.
4	8602	40/88/ND	Ilir Bircaj . Vasil Bircaj		713.00	10,903.00	45,522.00	0.00	32,457,186.00	32,457,186.00	Konfirmuar nga ZVRPP- Vlore.Sekuastro konservative.
5	8602	40/89	Shtet		362.00	10,903.00		0.00	0.00	5,400,000.00	Konfirmuar nga ZVRPP- Vlore.Mbi kete pasuri ka nje ndertim me siperfaqe 362 m2, (karburant) . Posedohet nga Ilir dhe Vasil Bircaj (benzinate). Vlera sipas preventivit te punimeve.
6	8602	36/191/ND	Batjar Bazaj, Luiza Xhaho		31.89	10,903.00	33,623	0.00	1,072,237.47	1,072,237.47	Konfirmuar nga ZVRPP- Vlore.
7	8602	42/10	P.P.V		82.66	10,903.00	62,188	0.00	5,140,460.08	5,140,460.08	Konfirmuar nga ZVRPP- Vlore.

79,245,263.31

KËRKESË

Shtetasi Ferdinand Gruda, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shpalljen të vdekur të shtetasit Lodovik Gruda, i biri i Luigjit dhe i Prendes, i datëlindjes 13.3.1965,

lindur në Shkodër dhe i zhdukur më datë 14.7.1986 në Shkodër.

KËRKUESI
Ferdinand Gruda

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë